



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH

Numri i lëndës: 2021:055090

Datë: 30.06.2022

Numri i dokumentit: 03190164

P.nr.20/21

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM DIVIZIONI PENAL, sipas gjyqtarit Sabaheta Kurteshi, në lëndën penale kundër të pandehurit **H.B. nga fsh..., Komuna e Dragashit**, për shkak te veprës penale **Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Kodi Nr.06/L-074 (KPRK)**, i akuzuar sipas **Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prizren/Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.503-14/21**, të datës **22.03.2021**, në bazë të nenit **358, par. 1, nën par. 1.3, të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (KPPK-së) dhe nenit 12, par.12.5, të Ligjit mbi ndërmjetësimin**, me datë 30.06.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. **APROVOHET** marrëveshja për ndërmjetësim, e lidhur në mes të pandehurit, H. B. nga fshati..., Komuna e Dragashit dhe përfaqësuesit të dëmtuarës – Autoriteti Komunal Pyjor Dragash, J. I. – Përgjegjës i njësisë nga fshati Sh., Komuna e Dragashit, në Qendrën e Ndërmjetësimit në Prizren NDM..nr.158/2022, e datës 20.06.2022.
- II. **HUDHET** Aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prizren/Departamenti i Përgjithshëm PP/II.nr.503-14/21, të datës:22.03.2021.
- III. **PUSHOHET** procedura penale për të pandehurin H. B. nga fshati..., Komuna e Dragashit, me nr. personal..., i lindur me.... ne fsh..., Komuna e Dragashit, me banim në Prizren, rr. S. R., nr..., Prizren, nga i ati O. dhe e ëma R., pensioner, ka te kryer fakultetin, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës për shkak te veprës penale, Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Kodi Nr.06/L-074 (KPRK).

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prizren/Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzën kundër të pandehurit H. B., nga fshati..., Komuna e Dragashit, per shkak te veprës penale , Vjedhja e pyllit nga neni 349 par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Kodi Nr.06/L-074 (KPRK).

Gjykata ka caktuar shqyrtimin gjyqësorë me datë: 26.05.2022 në të cilin ka prezantuar prokurori i shtetit Atnor Skoro, dhe i pandehuri, të cilët nderë tjera kanë deklaruar: nuk e kundërshton këtë propozim për dërgimin e kësaj çështje penale në ndërmjetësim.

Me propozimin e gjykatës dhe pajtimin e palëve dhe pas dhënies së mendimit dhe pajtimin nga prokurori i shtetit që këtë çështje penale juridike gjykata ta dërgoj për marrëveshje në procedurën e ndërmjetësimit, gjykata vendosi sipas detyrës zyrtare dhe këtë çështje penale juridike e konform ligjit KPPRK-së e dërgoj për ndërmjetësim.

Me datë 26.05.2022, kjo gjykatë komplet lëndën e dorëzon në Qendrën e Ndërmjetësimit në Prizren e që regjistrohet me nr. NDM. nr.158/2022.

Qendra e Ndërmjetësimit në Prizren në prani të palëve me dt. 20.06.2022 ka arritur marrëveshjen me prezencën e ndërmjetësueses A. H. nga Prizreni, ashtu që komplet shkresat e lendes i janë dorëzuar gjykatës me data; 20.06.2022.

Gjykata pas shikimit dhe vlerësimit të marrëveshjes për ndërmjetimi konstatoj se palët pa ndonjë kërcënim dhe me vetë dëshirë kanë shprehur gatishmërinë që kjo çështje të zgjidhet me ndërmjetësim dhe nuk kanë kontestuar asnjë nga pikat e marrëveshjes së ndërmjetësimit, vendosi që ta aprovoj marrëveshjen të bazuar.

Andaj, duke u bazuar në provat si më lart dhe në bazë të nenit 358, par. 1, nën par. 1.3, të KPPK dhe nenit 12, par.12.5, të Ligjit mbi ndërmjetësimin, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS DRAGASH –
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM, DIVIZIONI PENAL**

2021:055090, 30.06.2022

Gj y q t a r i/ja

Sabaheta Kurteshi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi nuk lejohet Ankesë.